



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr.14

Prishtinë, më 20.05.2015 ora: 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

Procesverbal

i mbledhjes së komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Kujtim Paçaku, Xhevahire Izmaqi, Shqipe Pantina, Pal Lekaj, Jelena Bontic dhe Zafir Berisha.

Mungoi: Alma Lama.

Në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Bordit të RTK-së dhe menaxhmenti i RTK-së, përfaqësuesit e OSCE-se, BIRN, GAP.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina, Mirjeta Heta dhe Flaka Zairi, praktikante në komision nga UNDP.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i raportit vjetor të Radio Televizionit të Kosovës, për vitin 2014;**
- 3. Formimi i grupeve punuese për monitorimin e ligjeve;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i raportit vjetor të Radio Televizionit të Kosovës, për vitin 2014;

Zenun Pajaziti – tha se, për raportin e RTK-së ka qenë një interesim nga grupe të ndryshme të interesit, se ajo që është e zakonshme, raporti ka arritur në kohë konform obligimit ligjor që RTK-ja ka për të raportuar, e sidomos tani në këtë periudhë kur komisioni është në fazën e plotësimit - ndryshimit të ligjit në fuqi për RTK-në.

Ai pastaj ia dha fjalën kryetarit të bordit të RTK-së

Ismet Bexheti – prezantoi raportin vjetor të punës dhe raportin financiar të RTK-së dhe tha se raporti është hartuar në formën ashtu siç është kërkuar nga zyra ndërlidhëse e Kuvendit të Kosovës me bordet e pavarura.

Raporti vjetor, duke përfshirë edhe raportin vjetor të auditorit të përgjithshëm, përfshinë mënyrën më reale të punës së RTK-së. Me gjithë sfidat, borxhet financiare me të cilat është ballafaquar RTK-ja si medium publik, bordi i RTK-së së bashku me menaxhmentin e saj ka zgjeruar skemën programore me kanale të reja të RTK-së, siç janë: RTK 2, RTK3, RTK4, për të cilat programe është nevojitur një teknologji e re.

Zenun Pajaziti – tha se sfidat e RTK-së nuk janë përfshirë në raport sidomos çështja e financimit, digjitalizimi dhe çështja e pronës.

Sadri Ferati – bazuar në vështërsitë që RTK-ja i ka pasur më herët, si çështja e pronës, financimit kemi prit që të adresohen çështjet reale dhe tani kur ne po shqyrtojmë raportin prapë shihet se çështja nuk po ecën, dhe nëse dikush deklarohej se në RTK ka progres dhe se janë tejkaluar vështërsitë, ai pyeti çfarë ka ndodh me borxhet, si janë krijuar ato, cilat janë përpjekjet e RTK-së për mbulimin e borxheve.

Kujtim Paçaku – duke përkrahur diskutimin e parafolësit, ai tha se u zbuluan dy çështje për RTK-në, racionalizimi dhe mungesa në kursime të cilat çështje duhet të publikohen. Ai gjithashtu, pyeti se a është përgatitur RTK-ja për digjitalizimin.

Shqipe Pantina – vërejtjet e saj i përqëndroi në përmbajtjen e raportit të RTK-së, pikërisht duke specifikuar nenin 38.4 të ligjit për RTK-në:

- Raportit vjetor i mungon debati publik konform nenit 38.3 të ligjit në fuqi;
- Raporti nuk e ka skemën programore;
- Raportit nuk ju ka bashkangjitur statuti i RTK-së;
- Vendimet e bordit nuk janë të inkorporuara në raport.

Pal Lekaj – sfidat e RTK-së janë shqetësuese dhe me të gjitha këto sfida jemi larg synimeve tona. Sa i përket raportit ka shpërputhje në shifra në mes të kodeve dhe në raport mungon politika e prioritetëve të RTK-së.

Zafir Berisha – është një raport i dobët dhe jo i detajizuar në krahasim me raportet e institucioneve tjera. Në raport tek tabela e shpenzimeve për mallra dhe shërbime, shpenzimet janë të mëdha dhe jo të detajizuara dhe për këto arsye, ai u deklarua se nuk do ta votojë raportin.

Xhevahire Izma – tha se është një punë pozitive që RTK-ja me një buxhet të njëjtë që nga viti 2011 ka arrit me funksionalizuar kanalet e reja RTK2, RTK3, RTK4.

Zenun Pajaziti – ia dha fjalën përfaqësuesëve të RTK-së që të përgjigjen në pyetjet e deputetëve.

Ismet Bexheti – raportin konform nenit 38 të ligjit për debat publik e harton menaxhmenti mbi bazë të nenit 33 të ligjit në fuqi.

Sa i përket skemës programore, RTK-ja e harton në vija të trasha dhe raporti për skemën programore është hartuar, por arsyeja pse nuk i është bashkangjitur raportit vjetor është se në këtë vit raporti është hartuar sipas formularit që kemi pranuar nga Kuvendi i Kosovës, ndërsa raportin periodik për punën e RTK-së e përfundojmë javën e ardhshme.

Mentor Shala – në përmbledhje të çështjeve të ngritura ai argumentoi se puna e RTK-së është punë transparente me fakte, se nga viti 2013 RTK-ja ka pasur vetëm 24 orë program ndërsa këtë vit RTK-ja transmeton 96 orë program. Jemi të përqëndruar në pagesën e borxheve të vjetra dhe

me një buxhet të njëjtë të cilin aktualisht e kemi është e pamundur që RTK-ja të krijoj pronë, RTK-ja ka pasur shpenzime në investime për programe, ndërsa sa i përket mbi punësimit poqese llogaritet proporcionalisht me orët e programit që RTK-ja transmeton, prej 24 orë në 96 orë nuk mund të themi që kemi mbipunësim.

Shqipe Pantina – RTK-ja i ka tejkaluar vijat buxhetore në këtë kontekst ajo pyeti se kush i miraton çështjet për skemën programore.

Zenun Pajaziti – e inkurajonë RTK-në për angazhime në përputhje me ligjin.

Konstatim:

Raporti vjetor i RTK-së nuk u votua në mungesë të forumit. Votimi është shtyer për mbledhjen e radhës.

Përgatitur nga :

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Kryetari i Komisionit
Zenun Pajaziti**
